

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI I SHOQËRISË  
“Ame Clinique & Spa” SHPK**

Ne baze te ligjit 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar, Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, i ndryshuar, si dhe ne perputhje me Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, me vullnetin e tij të lirë për të shprehur dhe në nenshkrimin e akt themelimit (që i bashkëngjitet këtij statuti) sot më datë 27.05.2025, me ortak Znj.Enkelejda Beshiri shpall si me poshte vijon:

**THEMELIMI**

**Neni 1**

**Ortaket themelues**

1.1 Shoqëria “Ame Clinique & Spa” shpk themelohet nga **Ortaket si me poshte:**

**1.Znj. Enkelejda Beshiri** shtetase Shqiptare, lindur me 15.08.1976 ne Tirane, me residence në Tiranë, mbajtese e Letërnjoftimit ID me numer 035351706 dhe Nr. Personal H65815060D

**EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE**

**Neni 2**

**Emërtimi**

2.1 Emërtimi i shoqërisë është “Ame Clinique & Spa” SHPK

**Neni 3**

**Forma ligjore**

3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4**

**Baza ligjore**

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

**Neni 5**

**Kohëzgjatja e veprimtarisë**

5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendren Kombetare te Biznesit (“QKB”).

5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë për një afat të pa percaktuar.

**Neni 6**

**Selia**

6.1 Selia shoqërisë është në adresën: Njësia 18, me numër pasurie 4/288-N18 dhe Njësia Nr. 7, me numër pasurie 4/288-N7, Zona Kadastrale 8160 ndodhur në Rruga “Pjetër Budi” – Tirane



- 6.2 Ortaket e shoqërisë mund të vendosin të hapin degë dhe/ose filiale dhe/ose adresa sekondare dhe/ose zyra përfaqësimi të shoqërisë si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj ose mund ti rregjistrojnë ato ekzistuese sipas ligjeve në fuqi.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashtë saj me vendim të Asamblese së Përgjithshme.

#### **Neni 7**

##### **Emblema. Vula**

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemen dhe vulën e saj.

#### **Neni 8**

##### **Objekti**

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: “Ushtrimi i veprimtarive në fushën e Dermo – Estetikës duke përfshirë por pa u limituar në: Import i pajisjeve dhe produkteve të ndryshme që lidhen me fushën e estetikës dhe janë në funksion të aktivitetit të qëndrës së estetikës, ofrimi i shërbimeve të ndryshme si dhe kryerja e trajtimeve si masazhe & Spa, kujdesi për flokët, parukeri, qënder estetike, sauna, ofrimin e shërbimeve për make-up, trajtim fytyre etj.”
- 8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblese së Përgjithshme.

#### **Neni 9**

##### **Kapitali**

- 9.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lekë.
- 9.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin shoqërisë ndahet midis ortakeve si me poshte vijon:
- a. Ortaku Themelues: Znj. Enkelejda Beshiri zoteron 100% të kapitalit të shoqërisë e barabartë me 1 kuote, me një vlerë të përgjithshme prej 100,000 (njëqind mijë) Lekë.
- 9.3 Kapitali është shlyer tërësisht.

#### **Neni 10**

##### **Transferimi i pjesëve të kapitalit. Kufizimet.**

- 10.1 Kuotat janë lirish të transferueshme tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” me amendimet perkatëse të tij, vetëm pasi të merret aprovimi nga Asambleja e Përgjithshme, e cila vendos me shumicë të thjeshtë.
- 10.2 Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj
- 10.3 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblese së Përgjithshme.

#### **Neni 11**



## **Rritja e kapitalit**

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

## **Neni 12**

### **Zvogëlimi i kapitalit**

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Asambleja e Pergjithshme. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblese se Pergjithshme raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme te Shoqërisë.

## **ORGANET E SHOQËRISË**

## **Neni 13**

### **Vendimet e Asamblese se Pergjithshme**

- 13.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë.
- 13.2 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme përfshijnë kryesisht:
- Percaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
  - Ndryshimin e emërimit të shoqërisë;
  - Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
  - Prishjen dhe/ose likuidimin e shoqërisë;
  - Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
  - Emërimin ose shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
  - Miratimin e bilancit të shoqërisë e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise së veprimtarisë;
  - Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - Transformimin e shoqërisë në forma të tjera;
  - Miratimi ose konfirmimi i vendimeve dhe veprimeve te Administratorit sipas percaktimeve te nenit 14 te ketij Statuti;
  - Të drejta dhe detyrime të tjera të parashikuara nga legjislacioni tregtar në fuqi.
- 13.3 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.
- 13.4 Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqërisë me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i eshte dorezuar Shoqërisë me kalimin e dites se 10-te pas dergimit.
- 13.5 Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqërisë, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marrjes së dokumenteve dhe projekt-vendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, adresen e faqes se internetit te Shoqërisë ku

mund te merret informacioni, po ashtu edhe rendi i dites, dhe duhet t'u njoftohet te gjithe Ortakeve te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me siper duhet te permbaje edhe vendimet e propozuara per çdo çeshtje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutit, teksti perkates duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.

13.6 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratoret dhe, kur eshte e zbatueshme, nga Ortaket.

13.7 Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete i ndryshem nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

13.8 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese ose kufizojne / zvogelojne te drejtat qe u jane njohur ortakeve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtezohet nga miratimi i Ortakut te interesuar / perkates.

13.9 Te gjitha vendimet e Asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret jane pergjegjes per mbajtjen e nje kopjeje te tij.

#### **Neni 14**

#### **Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

14.1 Asambleja e Pergjithshme mblidhet sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

14.2 Mbledhja e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit. Asambleja e pergjithshme thirret nga administratoret apo ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne asamblene e pergjithshme te shoqerise.

14.3 Asambleja e pergjithshme thirret nese:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjetër aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

#### **Neni 15**

#### **Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

15.1 Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, me njoftim nepermjet postes elektronike.

15.2 Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

15.3 Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur si me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjitha ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsi.

#### **Neni 16**

#### **Kuorumi i nevojshem dhe vendim-marrja**



16.1 Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

16.2 Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike.

16.3 Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se korumit te permendur me siper, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite. Asambleja e pergjithshme vendos me tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Per ceshtjet e tjera, asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres. Çdo kuote jep te drejten e nje vote.

16.4 Ortaket, qe nuk jane te pranishem, kane mundesine e pjesemarrjes ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme me mjete te ndryshme komunikimi, perfshire mjetet elektronike

## **Neni 17**

### **Administrimi**

17.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

17.2 Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojne Asamblese se Ortakeve.

Administratori i shoqërisë është Znj. Brunilta Karaj, shtetase Shqiptare, lindur me 22.04.1983 ne Tirane, me rezidence Tirane, mbajtese e Pasaportes me numer BC7137964 dhe Identifikuar me Nr. Personal I35422101T, me afat 5 vjecar dhe me të drejtë ripërtëritje.

## **Neni 18**

### **Kompetencat e Adminsitratorit**

18.1 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

18.2 Administratori për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të tij të parashikuar këtu më sipër, të drejta dhe detyrime të cilat janë parashikuar në legjislacionin tregtar në Republikën e Shqipërisë apo për çdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm për biznesin e shoqërisë në Shqipëri do të ushtrohet vetëm pas marrjes së miratimit paraprak të Ortakeve të shoqërisë. Miratimin paraprak i Ortakeve mund të jepet edhe nëpërmjet emailit të dërguar nga adresat zyrtare të Ortakeve të cilat do të njoftohen shoqërisë 10 ditë pas nënshkrimit të këtij Statuti.

18.3 Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- i. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- ii. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- iii. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara

Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në castin e revokimit të tij me vendim të Asamblese së Përgjithshme.

18.4 Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar me të tretet në emër të shoqërisë dhe në interes të saj në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji dhe Statuti i shoqërisë, si më sipër, ua jep shprehimisht ortakëve.

## **Neni 19**

### **Përgjegjësitë e Administratorit**

19.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

19.2 Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse

19.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

19.3 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

19.4 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.



19.5 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

19.6 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

19.7 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## **Neni 20**

### **Viti financiar**

20.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.

20.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

## **Neni 21**

### **Bilanci. Kontabiliteti.**

21.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

21.2 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

21.3 Kontabiliteti mbahet në gjuhen dhe monedhen shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit perkates. Për operacione të vecanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të vecanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.

21.4 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim nga Asambleja e Përgjithshme.

## **Neni 22**

### **Te Ardhurat. Dividendi**

22.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezerve për realizimin e qellimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatese.

22.2 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe Asambleja e Përgjithshme dhe do të pergjigjen deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimit të parë deri në tre ushtrimet vijues.

## **Neni 23**

### **Likuidimi**



23.1 Shoqeria prishet dhe kalon në likuidim: (i) me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve; ose (ii) në rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimtari për 2 (dy) vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKR; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) për arsye të tjera të parashikuara në ligj.

23.2 Prishja e shoqerisë njoftohet dhe regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit nga Administratori.

23.3 Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asamblëja e përgjithshme. Nëse asamblëja e përgjithshme nuk merr një vendim për emerimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, për të caktuar një likuidues.

23.4 Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykates zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqerisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykate brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

23.5 Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqeria tregtare prishet me vendim gjykate. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emerimin e tyre.

23.6 Administratoret e shoqerisë i njoftojnë për regjistrim, Qendres Kombëtare të Regjistrimit të dhenat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqerine, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre.

23.7 Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendres Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim gdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emerimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet ex officio, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

23.8 Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqerisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Likuiduesi merr persiper të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emerimit të tij.

#### **Neni 24**

##### **Mosmarrëveshjet**

24.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

#### **Neni 25**

##### **Klauzolë mbyllëse**

25.1 Përsa është shprehur në këtë statut i referohemi ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", dhe rregullores së brendshme të shoqerisë. Cdo ndryshim bëhet në të njëjten mënyrë sic është nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj shoqërie.

25.2 Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqerisë në regjistrin tregtar pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit.

25.3 Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të rregullohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ky Statut hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe me fuqi të njëjtë ligjore.

**Tirane më 27.05.2025**

**ORTAKU I VETEM  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"Ame Clinique & Spa" SHPK**

*Eukelyda Beqiri* 8